

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Xh.J, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.2 nënpar.2.1 dhe par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.85/2018 të datës 03.05.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.262/2018 të datës 19.07.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4 dhjetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit Xh.J, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.85/2018 të datës 03.05.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.262/2018 të datës 19.07.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.85/2018 të datës 03.05.2018, të dënuarin Xh.J e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par.2 nënpar.2.1 dhe par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 06.03.2018 deri më

datë 03.05.2018. I është konfiskuar mjeti – brisku dhe bateria e dorës, me të cilin është kryer vepra penale si dhe është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) €. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.262/2018 e datës 19.07.2018, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe mbrojtësve të të dënuarit Xh.J dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj aktgjykimin dhe t'i shqiptoj dënim më të butë.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.nr.195/2018 e datës 12.11.2018, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë i dënuari thekson se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, nuk është vlerësuar në mënyrë reale pranimi i fajësisë i cili pranim është bërë në fazë të hershme të procedurës penale e gjithashtu nuk është çmuar edhe pendimi i thellë i të dënuarit për veprën penale të kryer.

Pretendohet se me rastin e caktimit të dënimit nuk janë marrë parasysh rrethanat se i dënuari është mbajtës i familjes, se prindërit e tij janë në moshë të shtyrë dhe se i dënuari është prind i dy

fëmijëve të cilëve do tu mungon përkujdesi prindëror gjatë vuajtjes së dënimit të shqiptuar, e po ashtu kërkim falja e bërë të dëmtuarit dhe premtimi se nuk do të përsëritë vepra tjera penale

Më tutje pretendohet se përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin e lartë, këtë shkelje të ligjit penal ka nuk e ka korrigjuar as gjykata e shkallës së dytë e cila ka vërtetuar dënimin e shqiptuar pa i marrë parasysh rrethanat të cilat do të ndikonin në shqiptimin e dënimit më të ulët.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se në rastin konkret i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe pasi që gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal dhe me rastin e shqiptimit të dënimit ka marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në të cilat është bazuar me rastin e shqiptimit të dënimit, ashtu që bazuar në këto rrethana, të dënuarit i ka shqiptuar dënimin nën minimumin e dënimit të përcaktuar me ligj dhe atë duke u bazuar në mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore.

Andaj, në rastin konkret janë vlerësuar të gjitha rrethanat dhe gjykata nuk ka tejkalluar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit dhe me këtë drejt është aplikuar ligji penal, ashtu që pretendimi i të dënuarit i paraqitur në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë me shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.281/2018, më 4 dhjetor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta